



NACIONAL

Revistë periodike, letrare, kulturore, politike

Adresa: Ish-kinostudio "Shqipëria e re", Tiranë
E-mail: nacionalalbania@yahoo.com, bucpapaj@yahoo.com



First Lady më e shquar e Amerikës

Jacqueline Kennedy, emri i vajzërisë Jacqueline Lee Bouvier, lindi në Southhampton, më 28 korrik 1929.

Nga: Elida BUÇPAPAJ

— Faqe 19



Vranari: Nderim për gjithë letërsinë shqipe

Në datën 18 prill 2009, në Torino u zhvillua konkursi nacional i poezisë me emrin e heroit tonë kombëtar "PRINCI GJERGJ KASTRIOTI SKËNDERBEU".

Nga: Mujë BUÇPAPAJ

— Faqe 18

Kur prishet konkrenca

"Duhet të kemi xhelozia pozitive e jo negative. Xhelozia pozitive është kur nëse dikush e punon një shtëpi të mirë, tjetri përpiqet ta ndërtojë edhe më të mirë. E jo ta rrënojë shtëpinë e tjetrit nga xhelozia.

Nga Nazmi LUKAJ

— Faqe 2

KORRUPSIONI NË GJYQËSORIN E KOSOVËS

Korrupsioni edhe në pushtetin e gjyqësorit të Kosovës, është një prej dukurive më negative, shoqërisht e rrezikshme, që e pasivizon, e bllokon dhe e paralizon funksionimin e gjyqësorit në veçanti, si dhe të pushtetit shtetëror- në përgjithësi.

Nga Bekë LAJÇI - avokat

— Faqe 4

"SPAÇIADA"

Kush mund të blatonte mes maleve të Veriut të Shqipërisë, toponimin dhe misterin parashikues të bëmave të perandorëve të kuq, në gjysmën e dytë të shekullit të XX ... Spaç = Mos paç !?...që njeriu të mos kishte kurrë membranën e ujit, ekspresionin e Dritës...

Nga Novruz Xh. Shehu

— Faqe 6

Shkupi ngurron të vendosë marrëdhënie diplomatike me Kosovën

Qeveria e Maqedonisë: vendosja e marrëdhënieve diplomatike me Kosovën do të bëhet në momentin më të përshtatshëm.

— Faqe 3

Kosova prioritet për SHBA-të



Në foto Nënpresidenti amerikan, Xhozef Bajden dhe Kryeministri i Kosovës Hashim Thaçi

Intervista me këngëtarët e mirnjohur shqiptarë

ADMIR PREKAJ: JETOJ ME ÇFARË FITOJ NGAMUZIKA
GJENA: FITOJ MË SHUMË SE SHPENZOJ
YLLISHEHU: KENDOJ PER JU...
HIDA: PSEMË PELQEJNË TË GJITHA FEMRAT

— Faqe 23

GJITHÇKA RRETH GABRIEL GARCIA MARQUEZ CMIMI NOBEL (1972) DHE VIKTOR HYGO

— Faqe 12

POEZI TE LETRARËVE TË RINJ TË SHKOLLËS SE MESME "GJERGJ KASTRIOTI"

Faqe 22 — Durrës

Në BRENDESI

PORTRETI I GRUAS NË LETËRSINË PERËNDIMORE
Studim nga Gjekë MARINAJ

faqe 20

EFEJUARA E LUIGJ GURAKUQIT
Tregim i pabotuar nga Kolë Jakova

faqe 15

KUAJT EMANHATANIT
Poezi nga ROLAND GJOZA

faqe 7

AKEMI SOT POEZI?
Kritikë nga Sulejman Mato

faqe 9

TRE GËRMAT E SHENJTA
Tregim nga Bahri Myftari

faqe 8

POEZIA BASHKËKOHE BOSH NJAKE

faqe 10



PORTRETI I GRUAS NË LETËRSINË PERËNDIMORE



Në foto: Gjekë MARINAJ

Në botë sot e kësaj dite ka kritizuar, të cilët i kategorizojnë shkrihtarët e letërsisë perëndimore si urrjet të grave. Po të kritikojnë disa prej figurave më të rëndësishme të letërsisë perëndimore, midis tyre Shekspirin me misozhininë e tij, nuk do t'i kalonin kufijtë pasi besoj se kjo është e padrejtë. Nga analizat e hollësishme për poemën epike "Odiseja" të Homerit, tragjedinë antike "Antigoni" të Sofokliut dhe tragjedinë "Hamleti" të Shekspirin, nuk del as me prova bindëse dhe as me fakte urrjetja ndaj grave. Përkundrazi, të tre kundërshtuan plotësisht keqkuptimin e rolit të gruas në shoqëritë përkatëse dhe treguan përmes shkrimeve mirënjohjen e thellë për strategjitë dhe përpjekjet e grave ndër shekuj në përm-bushjen e qëllimeve për pavarësinë e tyre. Po të shkojmë pak më tutje me esenë, do të thoshim se: Homerit, Sofokliu dhe Shekspiri përmes figurave kryesore letrare, jo vetëm që u përpoqën t'i veshin personazhet femërore duke i portretizuar si, besnike, të guximshme dhe naive, por edhe i përshkruan shpesh herë krenare ndaj burrave.

Poema epike e Homerit prej shumë lexuesve do të pranohej se është për Odisenë dhe aventurat endacake për t'u kthyer drejt Itakës pas Luftës së Trojës. Në disa raste ne harojmë të marrim parasysh dy pjesët më të rëndësishme të mitologjisë. Së pari, Odiseja mbështet idenë se kthimi në shtëpi i djeg së brendshmi për hir të gruas dhe së dyti, Odiseja ia del të kthehet me ndihmën e hyjnise femërore. Homerit i jep protagonistit arsyen e plotë për ta shpërfillur vështrimin e ngulmët epshor të Nausikës, e cila "ishte shpërblyer prej zotave shumë nur" (206). Gjithçka që mori prej shtëpisë së Kalipso "përkujdesjet e shumta, sikur të ishte perëndi..." (206), për të nuk kishin më vlerë. Madje, edhe pse Kalipso i dhuroi Odisesë

pavdekësinë me kusht që të pranonte të qëndronte me të, nuk do të mund të krahasoheshin me dashurinë për t'u kthyer në Itakë, pasi "zemra e tij rrihte për gruan" (78). I mbështetur tek vetvetja dhe i vetëdijshëm nga përvoja e jetës mund të mendohej se, kundërshtimi ndaj dhuratave të tilla ishte më mirë të vdisje se sa të jetoje.

Homerit manipulon trupin, mendjen dhe shpirtin e Odisesë të shqetësohet për Penelopën, por nga ana tjetër kjo e bën inferior ndaj saj, së paku ndaj besnikërisë. Një shqetësim i tillë merr rëndësi kryesisht për atë gjini që autori i jep vlerësimin më të lartë moral. Ndërsa sipas tekstit Penelopa thjesht identifikohet si besnike e martesës, ka gjasa që ajo të jetë përcaktuesja e vlerave të Odisesë si një mundësi e të kundërtës. Sipas Odisesë, nuk ishte zakon për greket e asaj kohe t'i mbanin bashkëshortët me besnikërinë e tyre, e as t'u jepnin famë dhe forcë para syve të botës. Në të vërtetë, Homerit na sjell një tjetër personazh bindës, Klitemnestrën, problemet e së cilës ishin krejt ndryshe nga të Penelopës dhe mund të merren si paralelizëm në kushtet në të cilat ndodhej familja e Odisesë. Kur Agamemnoni, burri i saj kishte shkuar në Trojë, ajo shfrytëzoi Egistin, të dashurin për të vvarë bashkëshortin gjatë kthimit në shtëpi (78). Përmes krahasimit me Penelopën të cilën Homerit e vendos në fokusin që dëshiron ta shikonte, Klitemnestra paraqitet si shkelëse mizore e rregullave të shoqërisë.

Pavarësisht nga lajtmotivi i poemës epike, që Penelopa i mbetet besnike Odisesë, Homerit nuk i kufizon vlerat e saj vetëm tek besnikëria. Kjo do të tregonte se nuk kishte marrë mbështetjen e duhur për një nga temat kryesore të poemës epike, e cila është ruajtja e ekuilibrit të njohur të vlerave midis burrave dhe grave në Greqinë e vitit 700 para Krishtit. Sigurisht që Odiseja i njihte aftësitë e personazheve femra, të cilat ilustrohen si perëndesha apo ciklopë në poemën epike: ai takohet me Kirkenë, perëndeshën dhe magjistaren e deteve, që i shndërroi shokët e tij në derra (237) dhe me Sqillën, ciklopin me gjashtë kokë dhe njeri - gllabërues, që për "të shkuar pas anijes së saj" humbi gjashtë shokë (274).

Vetëm pasi i kthye, i thanë se Penelopa është treguar krenare ndaj burrave grekë, për t'i mbetur besnike, për të mbajtur djalin, shtëpinë dhe Itakën pa mbret, por të sigurt deri sa të kthehej. Megjithatë, "askush nuk do të mund të krahasohej me Penelopën për mashtrimin" (97), ajo ishte e zonja të mbante çdo mëtuës për më shumë se tre vjet në kolonat e

ndërtesës duke i mashtruar me thurjen e pëlhurës ditën dhe prishjen e saj natën (96). Homerit i dha karakterit të Penelopës jetëgjatësinë e duhur, forcën e mendimit kritik dhe durimin për ta përdorur me sukses në rrethanat që ndodhej, i cili kishte për qëllim të përdorte mençurinë e Penelopës si prologun e Odisesë drejtuar dhuntive të natyrës femërore, të afta t'i nxisin dhe mposhtin burrat, jo vetëm përmes besnikërisë, por edhe përmes formave të tjera.

Në tragjedinë "Antigoni", Sofokliu zbulon natyrën rebele të grave në një formë krejt të re. Ai, jo vetëm që krijon një protagoniste të guximshme tek Antigoni, por edhe e portretizon atë krenare në dyluftimin e rrezikshëm me sundimtarin, i cili ka vendosur të bind këdo "ta kuptojnë sa i hidhur ka për të qenë fundi / nëse nuk i binden ligjit" (163). Me këtë urdhër, Sofokliu e ktheu tragjedinë në analogjinë jo reale, prej së cilës spektatorët sigurisht që mund të nxirrnin gjykime të cilat i nxitën personazhet drejt radikalizmit. Ndoshta po të përqendrohemi me atë që do të përballej Antigoni, autori ilustroi një mbret kokëfortë dhe krenar, të fyer kur nuk i binden të tjerët, apo kur e këshillojnë se si të udhëheq. Pasi ka nxjerrë urdhrin kundër Polinesit, Kreoni qëndron i prerë ndaj urdhreve, pavarësisht pasojave, "nuk do ta varrosni, as nuk do ta qani" (168). Ndërkohë që tronditet nga guximi i Antigoni për të varrosur vëllanë, Kreoni zbaton menjëherë vendimin, duke e dënuar me varrosje së gjalli. Kjo me sa duket përbën një tjetër gabim në sundimin e Kreonit. Por, duke tërhequr vëmendjen, Sofokliu i përgatit spektatorët për fundin e mbretit, ndryshe nga fundi i Antigoni.

Megjithëse Sofokliu u jep të dyja personazheve mbështetjen e plotë për veprimet e tyre, nga njëra anë Kreonit që synon ligjin në qytet dhe nga ana tjetër Antigoni që kërkon të varrosë të vëllanë madhërisht, me mbylljen e tragjedisë përkrah vendimin trishtues të saj. Bindja e Hemonit për të arritur qëllimin, se lirimi i Antigoni ia vlente më shumë, se sa vetë jeta e tij, do të sillte "të qara në qytet për vajzën; të cilën menduan se po vdiste / dhe që gratë / do ta quanin një nga vendimet më të padrejta dhe të paligjshme" (vargu 690), Sofokliu paraqet më shumë se mbështetje, si për Antigoni, ashtu edhe gratë e tjera. Ai e ndëshkon mbretin për vendimet e padrejta, aq sa kur Antigoni vdes, vdes edhe bota e Kreonit. Tashmë e shkuara që e bëri mbret shkatërrrohet dhe bashkë me vdekjen e djalit të tij, Hemonit, vdes edhe e ardhmja.

Gjithashtu nuk është vendosmëria e vetmja temë që e bën

Nga Gjekë Marinaj

tragjedinë e Sofokliut "Antigoni", një nga tragjeditë antike greke në llojin e vet. Originaliteti i tragjedisë është një nga anët e tjera të medaljes që i udhëheq lexuesit e sotëm drejt mrekullive të fantazuara të vitit 441 para Krishtit. Si skena e tragjedisë, ashtu edhe fakti që autori është një nga bashkëpunëtorët e parë të letërsisë antike greke, na udhëheqin se si mund të lexojmë përmes rreshtave për të nxjerrë interpretime të tjera prej nëntekstit gjatë gjithë tragjedisë. Në librin që shkroi Sofokliu, si edhe në rolet e personazheve reale tek "Antigoni" mund të nxjerrim këto fakte. Për shembull, në një nga tiparet dalluese të Izmenës del natyra e bindur në kundërshtim të varrosjes së vëllait. Po e njëjta gjë mund të thuhet edhe për natyrën e Antigoni si një nga personazhet kryesore të tragjedisë. Ajo nuk arsyeton, por thjesht vepron sipas ndjenjave dhe fesë së saj. Megjithatë, Kreoni paraqitet si një sundimtar i rreptë nga jashtë, i cili nganjëherë shfaqet, sa kontradiktor, aq edhe i palogjikshëm. Në këtë mënyrë, a synon Sofokliu të heq emocionet e spektatorëve që ta pranojnë entuziazmin e personazheve reale dhe tragjedinë si të vërtetë? Për këtë unë do të thosha të kundërtën. Sipas leximit tim, Sofokliu krijoi personazhe reale, jo për të bindur lexuesin se tragjedia "Antigoni" është apo nuk është histori e vërtetë, por më tepër për të nxitur frikën dhe mëshirën që çonte drejt katarsisit, ku sipas Aristotelit përbën qëllimin e një tragjedie të vërtetë.

Antigoni shkakton emocione sepse është krijuar nga autori të veprojtë deri diku për t'i sjellë spektatorëve një farë trishtimi për shqetësimet dhe dhimbjen që po kalon. Sofokliu e përdor këtë personazh që të jetë e zjarrtë në plotësimin e ligjeve të zotave, të cilët u kërkonin grekëve të nderonin të parët e tyre dhe të varrosnin të vdekurit prej familjes. Kjo na jep përshtypjen se Antigoni është më se e vendosur në idetë e saj, aq sa Kreoni del i frikësuar prej Sofokliut: "Janë dy vajza, mendoj se njëra prej tyre / sapo e ka humbur toruan, ndër sa tjetra ka qenë ashtu gjithmonë" (183). Mbi të gjitha, Kreoni nuk ndihet i qetë për të mbështetur Antigoni, as me planet dhe as me veprimet e saj. Për më tepër ai përshkruhet, jo vetëm i zemëruar, por edhe i mërziut për të. Ne mund të shohim se Antigoni nuk bëri gjë tjetër, veç se ndoqi ligjet e jetës dhe zotave duke e varrosur të vëllanë. Sidoqoftë autori e çon Kreonin deri diku, sa për shkakun e tij, Antigoni i prishet gjithçka. Sofokliu e çon drejt vetëvrasjes, në mënyrë që të nderojë zotat dhe të vëllanë, Po-

linesin, e mërguar, i cili sipas Kreonit, "urdhëroi të digjej me zjarr nga fillimi deri në fund, vendlindja bashkë me zotat e tij" (210). Si personazh dramatik, Sofokliu i jep Kreonit të gjitha karakteristikat që duhet të ketë një mbret. Pasi e ka për detyrë si mbret, të mbrojë ligjet dhe t'i zbatojë ato. Këto dy personazhe janë në luftë me njëri - tjetrin dhe besoj se po veprojnë sipas vullnetit të zotave, prej të cilit ndriçohet mendja e Sofokliut, që u sjell spektatorëve ndjesinë e keqardhjes ndaj tyre.

Sofokliu e portretizon Antigoni si guximtare e madhe ku nga biseda me Izmenën, kuptohet se po ndjek atë që i thotë zemra: "ashtu siç e zgjedhe, vazhdo të mbetesh; por sa për mua / kam për ta varrosur. Më mirë / të vdes këshut" (163). Kjo ndikoi negativisht tek mbreti, i cili shpalli përpara qytetit se askush nuk do ta varrosiste Polinesin (168). Megjithatë Sofokliu e udhëheq Antigoni drejt mendimeve të ndryshme për jetën, vdekjen dhe përkujtimin; ajo e mbyllon me pluhur trupin e të vëllait, pavarësisht se Kreoni ka nxjerrë një vendim të patjetërsueshëm që e ndëshkonte ose e ndalonte atë. Ligji i mbretit ndikon lirinë e saj dhe padrejtësia e vdekjes ngadhënjehet mbi jetën. As vuajtjet nuk do ta ndalonin Antigoni të kryente një vdekje kaq të tmerrshme (164). Për më tepër, fakti që Sofokliu nuk e nxjerr Antigoni të gatshme të ndajë përgjegjësinë për vendimet e saj me të motrën Izmena, e bën personazhin më tërheqës dhe ndikues. Ajo i thotë Izmenës në fund të jetës "mos vdis bashkë me mua, as mos e bëj / atë që nuk munde të bëje ndonjëherë. Mjafton, që vdiqa unë" (182). Përmes elegancës artistike, Sofokliu e ndryshon Antigoni në personin i cili do të përfaqësojë (në botën ideale), vendosmërinë e grave të thjeshta greke. E zënë nga kurthi i ligjeve të njerëzve dhe zotave, Antigoni fitoi lirinë për t'i kapërcyer kufizimet dhe për të vepruar siç i thoshte zemra. Si përfundim me portretizimin e Antigoni të zënë në kurth nga ligji i njerëzve dhe zotave, Sofokliu i drejton spektatorët drejt frikës për fatin e saj, sidomos kur Kreoni shkatërron mizorisht të drejtat e tyre që sikurse thotë ajo i ka dhuratë nga zotat.

Sofokliu zbulon se mendimet personale të Kreonit nuk do të ndikojnë në rolin e tij si mbret dhe aq më pak në mënyrën se si mban nën kontroll dhe zbaton ligjin për të mirën e vendit. Por duke e bërë personazhin të ketë tipare reale, shndërrohet edhe më bashkëveprues me spektatorët. Për të ruajtur balancën midis karak-



→ terit të Kreonit si qytetar dhe rolit të tij si mbret, Sofokliu e portretizon Kreonin të sigurt se ai "...duhet të mbështetet tek drejtësia" (178). Sofokliu synon t'i veshë Kreonit disa gabime në vendimin e tij, por e vërteta është se nuk synon ta nxjerrë atë si zot. Kreoni kërkon t'i respektohet urdhri. "Sa të jem gjallë unë, asnjë grua nuk ka për të sunduar mbi fron" (181). Sofokliu i shton sundimit të mbretit edhe më shumë gabime, po të citojmë se Kreoni "nuk mund t'ia dorëzojë fitoren gruas." (187)

Ndërsa Izmena përballet me luftën midis Kreonit dhe të motrës, kupton se për të dhe të motrën "do të jetë më mirë të mos kërkojnë të pamundurën" (165). Për ta dramatizuar frikën e saj përpara spektatorëve, Sofokliu zgjedh heshtjen si një mundësi për të shprehur mendimin. Sofokliu rezervon një vend të rëndësishëm në tragjedi, edhe pse arsyeja e mbytyes së emocioneve mund të shihet e lidhur më shumë me shtypjen kulturore të grave, se sa me rolin e kufizuar social si qytetare. Qëndrimi i Izmenës sjell shqetësime në të njëjtën kohë, ndryshe nga natyra e saj paqësore. Ajo e do vëllanë, por duke njohur kushtet, përpriqet t'i kujtojë së motrës, Antigoni: "duhet ta dimë se jemi gra, / nuk kemi ardhur në jetë të luftojmë me burrat, / pasi sundohemi prej tyre të cilët janë më të fortë se sa ne" (163). Megjithatë në fund, Izmena këmbëngul të flasë rreth fatit tragjik të së motrës duke marrë përgjegjësinë personale për vendimin e Antigoni: "Motër, mos më harro / edhe unë le të kem të njëjtën vdekje me ty, me të njëjtin nderim për të vdekurin" (182). Duke e portretizuar si personazh në mbështetje të së motrës është gati të pranojë fajin, por jo të kryejë "krimin", ndoshta Sofokliu mund t'i ketë bërë spektatorët të ndiejnë keqardhje dhe frikë për Izmenën, se një ditë edhe ata mund të ndodhen në të njëjtat rrethana.

Nga sa kam lexuar kohë më parë nga "Poetika" e Aristotelit, qëllimi i një tragjedie të suksesshme në shekullin e pestë ishte ngjallja e mëshirës dhe frikës që do të çonin drejt katarsisit. Sofokliu e arriti me sukses këtë gjë. Në tragjedinë "Antigoni", Sofokliu rrëfen një histori të ndjeshme sociale, përmes së cilës spektatorët duhet të kenë ndjerë keqardhje për Antigoni dhe frikë për të ardhmen sepse jetonin në një botë ku ka zënë rrënjë tragjedia. Në çastin kur Antigoni vdes, edhe mbretëria e Kreonit përmbysset. Befas e shkuara që e bëri mbret ndali dhe e ardhmja vdiq fill pas vdekjes së djalit të tij. Megjithatë është e rëndësishme të kuptojmë se fati tragjik i personazheve nuk portretizon plotësisht përsosmërinë e Antigoni. Sipas leximit tim, një nga sukseset më të mëdha të tragjedisë është mënyra se si dramaturgu i çon spektatorët drejt katarsisit.

Pavarësisht kohës së gjatë dhe pengesave intelektuale që ndoshta ndërhyjnë gjatë ndryshimit të letërsisë perëndimore, sërish Shekspiri ndoqi hapat e Homerit dhe Sofokliut duke vazhduar t'i portretizojë personazhet femra si unike në shumë këndvështri-



me të veprës. Shekspiri krijoi personazhin e Ofelisë që t'i sjellë botës femërore shumë më tepër nga sa mund të rrekin sytë. Ai na e vërteton katërcipërisht gjatë shfaqjes së tragjedisë se Ofelia dhe Gertruda janë epiqendra të fillimit të kryeveprës "Hamleti", i cili shfaqet si misozhinist, por nga ana tjetër, hap dy dritare nga mund të kuptojmë shkaku dhe veprimet e tij. Së pari, gjithë bota e Hamletit vërtitet rreth kësaj çështjeje, "Të rrosh, a të mos rrosh" (45) e cila i hedh dritë të plotë tekstit prej qëndrimit të tij të dobët intelektual. Së dyti, Hamlet shpreh të njëjtën melankoli, hidhësi dhe urrejtje ndaj Klaudit, xhaxhait të tij.

Jo vetëm Hamlet, por edhe disa nga personazhet e tragjedisë në marrëdhënie me Ofelinë, janë thjesht mjete letrare, të cilat autori i përdor për të arritur qëllimin, se bota do të ishte një vend më i mirë në se do t'i kushtonim më shumë rëndësi dhe do të zbatonim atë që gratë duhet të thonë. Nga tragjedia zbulojmë dilemën e Hamletit "Të rrosh, a të mos rrosh" (45) e cila vjen si pasojë e pakënaqësisë për martesën e menjëhershme të nënës së tij dhe qëllimit të saj për t'iu dorëzuar Klaudit, i cili i vrau babanë. Megjithatë, mbështetja e Shekspirit për njërin nga personazhet femra të tragjedisë, nuk i dhanë Ofelisë mundësitë më të mira praktike se sa Hamlet. Ajo gjithashtu e gjen veten në rrethana tepër të vështira. Në përgjithësi zhgënjimi i Hamletit me gratë dhe në veçanti me të (e cila njëherë plotësonte planin e të atit dhe pastaj spiunonte ndaj tij) e bën Ofelinë t'i meditojë fjalët e rënda që ai i tha: "Mbylleni në manastir" (46). E krijuar me mjeshtëri nga autori, fjalët e Hamletit nxitën acarimin e Ofelisë, pasi ai ishte i vetmi që iu përkushtua me dashuri të sinqertë (17). Si të mos mjaftonte me kaq, për t'u përballur me protagonistin e tragjedisë dhe Ofelinë në të njëjtat pozita familjare, Shekspiri do t'i shtonte karakterit pothuajse të dobët të Ofelisë,

edhe vdekjen e babait të saj, Polonit. Ai vdiq më tepër si viktimë e komplotit të tmerrshëm që e shndërroi jetën e Hamletit në ankh.

Në këtë moment të tragjedisë do të më duhet t'ju them se, Shekspiri e portretizon Ofelinë dhe mbi të gjitha gratë, si të ishin një hap më përpara Hamletit dhe personazheve të tjera maskullore të tragjedisë në lidhje me vendimmarrjen e rëndësishme që mund t'i mbronte apo shkatërronte jetët njerëzore. Në të shkuarën si Hamlet, ashtu edhe Ofelia, me sa dimë i kishin jetët në fije të perit. Megjithëse deri diku për këto dy personazhe, vdekja është shkaku dhe pasojë e shkatërrimit, Shekspiri zgjedh hakmarrjen e Hamletit që ishte lufta me shpata dhe helmimi i katër personave. Nga ana tjetër Ofelia e shpreh hakmarrjen me këngë melankolike, por kësaj radhe duke mos kërkuar më ndihmën e burrave si zakonisht, por më tepër duke u mbështetur në artin e poezisë, muzikës dhe në fund një tufe lule para se të vdiste.

Sipas mendimit tim, po t'i kthehem epokës së Shekspirit aty rreth vitit 750 para Krishtit, në kërkim të fakteve që do të çonin drejt harrësës së grave nga shkrimtarët e letërsisë perëndimore me shkrimet e tyre, do të ishte qesharake. Orvatje të tilla tregojnë, ose paafësi për të vlerësuar përmbajtjen e veprave nga "Odiseja", "Antigoni" dhe "Hamlet", ose thjesht qëndresë për t'u sjellë në këtë mënyrë. Sipas këtyre veprave, lidhja e krijuar me personazhet femra shfaqet si kënaqësi egoiste dhe mbështetje reciproke. Natyra e letërsisë perëndimore me të cilën kënaqemi edhe sot e kësaj dite, nuk do të ishte kjo që është, nëse nuk do të kishim shkrimtarët si: Homerit, Sofokliu dhe Shekspiri, të cilët i dhanë jetë Penelopës së zgjuar, besnike, e të duruar, Antigoni trimëreshë dhe Ofelisë së brishtë.

**Përktheu nga anglishtja:
Irena PAPIŃGI**

IN MEMORIAM PËR MJESHTRIN E SONETIT,
POETIN ENVER GJERQEKU

Poeti i ndjeshmërisë

Nga Nexhmedin SPAHIU



Në foto: Enver GJERQEKU

Para pak kohësh ndroji jetë poeti Enver Gjerqeku. Kujtimet e mia me Enver Gjerqekun lidhen perms librave të leximit në shkollë fillore dhe të mesme. Kontakti im i drejtëpërdrejtë me poetin Enver Gjerqeku ishte në ditët e mia studentore. Në vitin 1984 kur unë sapo kisha filluar vitin e parë të studimeve në Fakultetin e Shkencave Matematiko-Natyrore patëm themeluar Grupin Letrar "Pjetër Bogdani". Si kryetar i parë i këtij grupi letrar organizoja mbrëmje letrare të cilat mbaheshin në Sallën e Kuqe të Fakultetit Filozofik. Mëqë pas demonstrative të vitit 1981 manifestimet kulturore ishin të pakta në numër, këto mbrëmje letrare ishin një ngjarje kulturore që tërhiqte gjithë njerëzit që nga elita letrare e kohës e deri të mësuesit e arsimitarët nëpër fshatra të largëta të Kosovës. Salla e cila asokohe kishte 680 ulëse ishte tepër e vogël për të zënë dashamirët e poezisë në çdo rast. Shumica e publikut qëndronin në këmbë. Publiku priste me ovacione të mëdha hyrjen e figurave të letrave shqipe të kohës të cilët nuk u mungonin pothuaj kurrë këtyre mbrëmjeve letrare: Esad Mekuli, Hasan Mekuli, Ibrahim Rugova, Engjëll Sedaj, Ali Podrimja, Azem Shkrelly, Nuhi Vinca, Agim Vinca, Agim Mala, Jusuf Buxhovi, etj. por që ovacionet më të mëdha zakonisht rezervoheshin për Mirko Gashin e sidomos për Rexhep Qosjen.

Si organizator, shpesh ndodhesha në pozitë të palakmueshme kur publiku nderonte ta zëmë më shumë ndonjë poet tjetër se sa Esad Mekulin i cili ishte dhe mbetet babai i letërsisë shqipe në ish-Jugosllavi dhe që duhej dhënë respekti në mos për këtë fakt të rëndësishëm, të paktën për faktin tjetër se ishte më i vjetri për nga mosha. Por si ta dirigoje publikun prej mijëra vetave? Kjo ishte e pamundur. Mbrëmja e cila më së shumeti më ka lënë përshtypje ishte ajo e vitit 1986. Mbrëmja letrare po i kushtojë 120 vjetorit të lindjes së Ndre Mjedjes. Në sallën e stërbushur ovacionet renditeshin njeri pas tjerit sapo futeshin poetët dhe shkrimtarët e njohur. Pas një ovacioni të tillë për Mirko Gashin dhe Esad Mekulin që u futën në sallë pothuaj njëkohësisht në portën e sallës u paraqit poeti Enver Gjerqeku. Në sale filluan vërshllimat. Ishte hera e parë që ndodhte kjo gjë. Arsyen e kuptova menjëherë. Në atë kohë poeti Enver Gjerqeku sapo ishte zgjedhur anëtar i Komitetit Qendror të LKJ-së. Studentët kosovarë në atë kohë ishin

tejt mase të joshur pas Enver Hoxhës dhe Partisë së Punës. Kjo ishte arsyeja e vërshllimave të tyre. Si njëri jokonformist që isha, plus përgjegjësinë që kisha ndaj musafirët që e kisha ftuar dhe që kish pranuar të vinte tek pas lutjeve të mia të shumëta, zbrita nga podiumi dhe shkova i zgjata dorën e mirëseardhjes Enver Gjerqekut. Ky ishte një gjest respekti që zakonisht nuk e bëja asnjëherë për askend, për shkaku se musafirët ishin të shumtë dhe nuk u kushtoja kujdes asnjëherë këtyre ceremonive të mikëpritjes. Kjo gjë pakësoi vërshllimat. Këto vërshllima u ndalen tek kur Esad Mekuli bëri të njëjtën gjë pas meje, e përqafoi dhe i ofroi vendin pranë tij. Bëra hapjen e zakonshme të mbrëmjes letrare dhe fjalën hyrëse për veprën e Ndre Mjedjes ua dhash fillimisht Hasan Mekulit e më pas Ibrahim Rugovës. Vijova me prezantimin e poetëve dhe studentëve poetë por gjatë gjithë kohës e kisha hallin se si do të jetë reagimi kur do ta ftojë në podium Enver Gjerqekun. Vetë poeti Enver Gjerqeku me dergoi një copë letre ku po më thoshte që mos ta ftojë. Disa nga anëtarët e kryesisë së klubit letrar po më shkruanin të njëjtat sugjerime. Unë megjithatë vendosa ta çoj deri në fund. Para se t'i ftoja për leximin e punimeve të tyre zakonisht u bëja njëfarë prezantimi përmes vargjeve apo titujve të veprave të tyre. Në momentin kulminant të mbrëmjes vendosa ta ftoj në podium Enver Gjerqekun.

Nisa me vargjet e Ndre Mjedjes: "Ishin këto vargjet e Ndre Mjedjes i cili në letërsinë e traditës njihet si mjeshtër i sonetit".

Prap ovacione edhe më të mëdha. Vazhdova më tej: "Në letërsinë tonë bashkëkohore një poet i yni, mysafir i yni i sontëm, gjithashtu njihet si mjeshtër i sonetit. Ftoj në podium mjeshterin e sonetit, poetin Enver Gjerqeku me poezinë "Bukuria e Tanushës". Në këtë moment kulminant shpërthyen duartrokitjet më të mëdha të dëgjuesve ndonjëherë në Sallën e Kuqe. Poetin Enver

Gjerqeku e kapluan lotët. Nuk mund të fillonte leximin e poezisë.